

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (GIZ), PËR PROJEKTIN “KËSHILLIMI PËR MIGRACIONIN NË SHQIPËRI”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllin ratifikimin e marrëveshjes e cila synon forcimin e kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve kuadër për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere. Ky objektiv do të ndiqet në mënyrë aktive në këto fusha veprimtare:

- Këshillimi për migracionin: lufta kundër migracionit të parregullt, nëpërmjet rritjes së mundësive të marrjes së informacionit për rrugët ligjore të migracionit për migrantët e mundshëm, me anë të këshillimit për migracionin; marrja e informacionit lidhur me perspektivat e arsimimit dhe të tregut të punës për migrantët e mundshëm dhe të kthyerit;
- Këshillimi për politikën e migracionit: përmirësimi i politikave për migracionin e ligjshëm dhe kontributet zhvillimore të migracionit, rritja e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit dhe dialogut.

Objektivat e sipërpërmendur janë pjesë e programit global, “Migracioni për zhvillim” (PME), të autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), të cilat, që prej 23 dhjetorit 2015 janë autorizuar të të zhvillohen edhe në Republikën e Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Menaxhimi i migracionit është parashikuar si një prej prioriteteve kryesore të integritimit.

Gjithashtu, objektivat e marrëveshjes janë në përputhje me masat e parashikuara në përparësinë strategjike A të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kjo marrëveshje ka si bazë marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 21 tetor 1988 për bashkëpunim teknik dhe marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për punësimin e punëtorëve për zgjerimin e njohurive të tyre profesionale dhe gjuhësore, nënshkruar më 10.12.1991.

Gjithashtu, marrëveshja ka si bazë rezultatet e bisedimeve për bashkëpunimin për zhvillim, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtura në Tiranë, më 12 korrik 2016.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje synohet të luftohet migracioni i parregullt, duke ofruar informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës dhe duke informuar lidhur me arsimin dhe formimin profesional e perspektivat e tregut të punës, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri.

Bashkëpunimi do të fokusohet në:

- fushat e këshillimit për migracionin dhe, më konkretisht, në këshillimin dhe informimin e grupeve të caktuara mbi mundësitë e migracionit të ligjshëm të punës dhe perspektivat e arsimimit dhe të punësimit në Shqipëri;
- përditësimin dhe ofrimin e materialeve informative rreth migracionit të punës, mundësitë për hyrje në tregun gjerman të punës dhe trajnimet përkatëse për personelin e sporteleve të migracionit;
- ngritjen e kapaciteteve të sporteleve ekzistuese të migracionit të SHKP-së lidhur me informimin mbi rrugët ligjore të migracionit të punës;
- përmirësimin e bazës të të dhënave për aktorët në terren dhe situatën e grupeve të synuara si dhe krijimin e një rrjeti me aktorët përkatës në fushën e arsimit dhe punësimit.

Për përmbajtjen dhe përparësitë kryesore të këtij bashkëpunimi u ra dakord gjatë *workshop*-it të mbajtur në Tiranë, më 23 mars 2016, në kuadër të projektit të bashkëpunimit ndërmjet GIZ dhe ish-Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.85, datë 14.2.2018, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri””.

Marrëveshja është nënshkruar nga palët dhe po paraqitet për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”

Në pikën 1 të marrëveshjes përcaktohet objektivi kryesor i programit global, “Migracioni për zhvillim” (PME), i ndarë në 5 fusha veprimtarie.

- Këshillim për politikën e migracionit;
- Këshillimi për migracionin;
- Kthimi i migrantëve i orientuar nga zhvillimi;
- Bashkëpunimi me diasporën;
- Ide biznesi për zhvillim.

Në këtë pikë bëhet një përcaktim i programit global “Migracion për Zhvillim” (PME).

Në pikën 2 përcaktohen kontributet për projektin nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it.

Në përputhje me procesverbalin përmbledhës të bisedimeve, në lidhje me bashkëpunimin për zhvillim ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe

qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtura në Tiranë në datën 12 korrik 2016, qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i ofrojë GIZ-it deri në 1 500 000 (1 milion e pesëqind mijë) euro për kontributin gjerman. Kjo shumë do të përfshijë edhe shpenzimet e bëra nga Organizata Zbatuese Gjermane.

Kontributi është i ndarë në 4 pika, si më poshtë:

- i. Sigurimi i ekspertëve;
- ii. Furnizimi me materiale dhe pajisje;
- iii. Kostot operative dhe administrative;
- iv. Kontribute të tjera.

Në pikën 3 përcaktohen kontributet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), të ndara në katër pika, si më poshtë:

- i. Sigurimi i 10 ekspertëve, që do të nënkontraktohen nga GIZ dhe përfshirja e 4 personave (personelit ndihmës), staf i MFE-së, për zbatimin e projektit (duke përfshirë institucionet e varësisë);
- ii. Kostot;
- iii. Sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe i ambienteve të punë;
- iv. Kontribute të tjera, ku parashikohet që MFE-ja të mbështesë bashkëpunimin me njësi të tjera kombëtare dhe rajonale të kësaj ministrie në zbatimin e projektit, si dhe me njësi të tjera.

Në pikën 4, përcaktohen dispozitat e tjera, të cilat përfshijnë: vlerësimin, komitetin drejtues, pezullimin e kontributeve dhe përfundimin e marrëveshjes, afatin e marrëveshjes, rregullimin e marrëveshjes, forma me shkrim, marrëveshjet me organizata zbatuese të veçanta, marrëveshjet e qeverisë dhe hyrja në fuqi të marrëveshjes.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji dhe marrëveshja janë hartuar nga ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe janë vazhduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji që ratifikon marrëveshjen ka efekte financiare të llogaritura në masën 45 000 euro për vitin 2019 dhe 45 000 euro për vitin 2020, në zërin “Kosto lokale e TVSH-së”, të cilat janë planifikuar në projektbuxhetin afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu, në rishikimin e buxhetit të vitit 2018 janë planifikuar fondet për TVSH-në, mallra dhe pajisje, brenda tavanëve buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

KËSHILLI I MINISTRAVE